



UNIVERSITETI
METROPOLITAN
TIRANA

Nr. 247/ Prot.
Dt. 20.03.2023

REZULTATET E VLERSIMIT TË PROCESIT TË MËSIMDHËNIES

VITI AKADEMIK 2022 - 2023, SEMESTRI I

NIKOLLA NIKA

Mars 2023



Raport

mbi rezultatet e anketimit të studentëve të UMT për vlerësimin e procesit të mësimdhënies

Përgatitur nga:

Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë e Universitetit Metropolitan Tirana, UMT

Periudha e realizimit të pyetësorit:

Dhjetor 2022

Hartimi i Raportit:

Mars 2023

Universiteti "Metropolitan Tirana"

web: www.umd.edu.al

Email: inf@umd.edu.al



Permbajtja

I. HYRJE	4
II. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT	5
III. METODOLOGJIA DHE REZULTATET	7
IV. REZULTATET	9
V. PERFUNDIME DHE REKOMANDIME	22

Ne vazhdim te eksperiencës disa vjeçare në proceset e brendshme të sigurimit të cilësisë, Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) në Universitetin Metropolitan Tirana (UMT) në bashkëpunim me njesinë IT, zhvilluan me sukses anketimin e studentëve për mbledhjen e opinioneve lidhur me procesin mesimor gjatë semestrit të Parë të vitit akademik 2022 -2023.

Për të vlerësuar opinionin e studentëve në këtë semestër u hartua një pyetësor i përgatitur në formatin 'Google form'. Në të njëjtën kohë pyetësi u përshtat dhe i u bashkëngjiti platformës "edu4school". Në këtë mënyrë u bë e mundur që pyetësi të plotësohej on-line si nepermjet linkut të 'Google form' ashtu edhe nepermjet platformës "edu4school".

Pyetësi ka qenë i hapur për të mbushur në periudhën 7-21 Dhjetor 2023 .

Plotësimi i pyetësit të studentëve të Universitetit Metropolitan Tirana ka qenë anonim, individual dhe jo i detyrueshëm. Informacionet për përmbajtjen dhe plotësimin e tij janë bërë të ditur në mënyrë të vazhdueshme gjatë fazës së plotësimit të pyetësit. Çdo student që ka gjykuar se plotësimi i pyetësit është në të mirë të tij dhe institucionit, e ka plotësuar atë duke kontribuar në këtë mënyrë në njohjen e drejtuesve me mendimin e tyre për Universitetin Metropolitan Tirana dhe aspekteve të veçanta të funksionimit të tij.

Pyetësi përmban pyetje lidhur me të gjithë aktivitetin e pedagogëve gjatë procesit të mesimdhënieve dhe të kontrollit të dijeve si dhe materialet mesimore që ju ofrohen studentëve.

Rezultatet e pyetësit u analizuan për të nxjerrë në pah vlerësimin real të studentëve dhe për të adresuar problematikat e evidentuara. Këto rezultate janë publikuar në këtë raport.

Si gjithmonë, rezultatet e anketimit duhet të konsiderohen të nivelit informativ.



I. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Pyetësi i studentëve të UMT është një procedurë përvitëshme që kryhet nga NJSBC me qëllim monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në institucionin tonë duke u fokusuar në indikatorë të përgjithshëm dhe indikatorë specifikë të vlerësimit dhe monitorimit.

Ky sondazh që përgjithësisht realizohet çdo semester ka disa objektiva madhorë të cilat lidhen me mbledhjen e informacioneve periodike nga studentët për ecurinë e procesit mësimor, vlerësimin e provimeve të ndërmjetme dhe të praktikave profesionale që realizohen gjatë vitit akademik. Ky opinion ndihmon vendimmarrjen e organeve drejtuese në përmirësimin e performancës së universitetit në drejtime të cilat sipas studentëve duhet të performojnë më mirë. Në të njëjtën kohë, analiza e rezultateve shërben për përpunime krahasuese nga viti në vit në lidhje me ecurinë e treguesve të ndryshëm të universitetit. Njëkohësisht, informacionet u shërbejnë studentëve dhe maurantëve për të njohur më mirë UMT nën këndvështrimin e studentëve.

Për zhvillimin e këtij anketimi, NJSBC ka zbatuar disa akte të cilat janë orientuese dhe njëkohësisht detyruese për institucionet e arsimit të lartë.

Në hartimin e pyetësorit dhe të sondazhit është pasur parasysh dhe politika e cilësisë së UMT.

Anketimi i studentëve është një proces i parashikuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 datë 22.7.2015, Kreu X, Neni 103 "*Sigurimi i brendshëm i cilësisë*", si një ndër masat e marra në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies ku thuhet shprehimisht:

- *Institucionet e arsimit të lartë janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Struktura dhe funksionimi i njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë.*
- *Njësia e sigurimit të cilësisë vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore.*
- *Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, ajo organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi.*
- *Njësia e sigurimit të cilësisë realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga institucioni i arsimit të lartë.*
- *Raportet e vlerësimeve, të kryera nga njësia për sigurimin e brendshëm të cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë, përdoren si burim për vlerësimin e jashtëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.*



Po ashtu ky sondazh bazohet në standardet dhe kriteret e cilësisë të programeve të studimit, pjesë e Kodit të Cilësisë në arsimin e lartë (*Për programet e studimit të ciklit të parë bachelor, ciklit të dytë "master profesional", ciklit të dytë "master i shkencave" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë "master i shkencave"*)

"III. Mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi dhe kompetencat

Standardi III.

Kriteri 1 *institucioni ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit*

Kriteri 2. *Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.*

Kriteri 3. *Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.*

Kriteri 4. *Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.*

Kriteri 5. *Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies."*

Ky pyetësor bazohet në Statutin e UMT, Rregulloren e institucionit dhe Rregulloren e NJSBC ku në themel të së cilëve është monitorimi i vazhduar dhe sigurimi i cilësisë së programeve të studimit dhe i mësimdhënies.

Më poshtë do të pasqyrojmë në mënyrë të detajuar të gjithë hapat e ndjekur për realizimin e procesit të anketimit e deri në gjenerimin e rezultateve dhe hartimin e përfundimeve.



II. METODOLOGJIA

Pyetësi u përgatit nga NJSBC dhe synon mbledhjen e informacionit rreth kenaqesise se studenteve me aktivitetin e pedagoqeve gjate ores se mesimit, materialeve mesimore dhe gjate kontrollit te dijeve. Përveç ketyre aty jane perfshire edhe disa pyetje per mbeshtetjen qe marrin studentet nga strukturat akademike dhe administrative te UMT.

Pyetësi, qe eshte bashkengjitur ne aneksin 1, permban 25 pyetje qe janë të fokusuara në 4 seksione:

Seksioni A:

Identifikimi i studentit – 3 pyetje (Fakulteti, programi, viti i studimit)

Seksioni B:

- Mesimdhenia - 8 pyetje (me 5 opsione)
- Kontrolli i dijeve – 5 pyetje (me 5 opsione)
- Vleresim total i lendes/pedagogut – 2 pyetje (me 5 opsione)

Pyetjet e ketij seksioni perseriten per te gjitha lendet/pedagoget e semestrit (jane parashikuar 5 lende)

- Komentet te pergjitheshme mbi lendet/pedagoget

Çdo seksion përbëhet nga një seri pyetjesh të cilat fokusohen në aspekte të veçanta të procesit të mesimdhenies e mesimnxenies nepermjet te cilave tentohet te mblidhet informacion mbi vlerësimin nga ana e studentit të lëndës dhe pedagogut përkatës.

Përgjigjet e pyetësorëve janë transformuar ne formatin Excel dhe me pas janë përpunuar me metoda grafike dhe statistikore.

Ne pyetjet e seksionit B, qe lidhen me vleresimin e aktivitetit te pedagogut gjate mesimdhenies dhe kontrollit te dijeve, studentit i kerkohet te shprehet se ne cfare shkalle eshte dakort (Shume dakort, Dakort, Neutral, Jo dakort, Aspak dakort) me pohimet qe lidhen me aspekte te ndryshme te ketyre aktivitetve. Ne pyetjen e fundit atyre i kerkohet te vleresojne aktivitetin e pedagogut ne teresi sipas shkalles – Shkelqyeshem, Shume mire, Mire, Mjaftueshem dhe Jo mire.

Per vleresimin me note te pedagoqeve, vleresimet e shkalleve te mesiperme jane konvertuar ne nota sipas tabelës me poshte.



Vleresimi	Nota	Vleresimi	Nota
Shume dakort	10	Shkelqyeshem	10
Dakort	8	Shume mire	8.5
Neutral	6	Mire	7
Jo dakort	4	Mjaftueshem	5
Aspak dakort	2	Jo mire	4

Ne kete menyre vleresimi me note i pedagogeve eshte kryer ne dy menyra. Menyra e pare eshte ajo e konvertimit ne note te pergjigjeve te pyetjes "Vleresimi juaj mbi aktivitetin e pedagogut", ndersa menyra e dyte lidhet me konvertimin ne note te pergjigjeve te dhena per aktivitetet e ndryshme te procesit te mesimdhenies dhe te kontrollit te dijeve.

Perveç vleresimit te mesiperme kemi gjykuar se eshte me interes te vleresojme edhe shperndarjen e pergjigjeve te pyetjeve duke i grupuar ato ne tri grupe kryesore si me poshte:

Grupi	Pergjigjet e pyetjeve me vleresim
"Te kenaqur"	"Shume dakord" e "Dakord"
"Neutral"	"Neutral"
"Te pa kenaqur"	"Jo dakord" dhe "Aspak dakord"




III. REZULTATET

❖ Pjesëmarrja ne anketim


Te dhenat e paraqitura ne kete raport i perkasin nje periudhe 2 javore gjate se ciles pyetesorin e kane plotesuar nje numer studentesh si me poshte.

Ne rang Universiteti kane marre pjese ne anketim 756 studente, apo rreth 67% e numrit total te studenteve. Duhet theksuar se ka te dhena te vlefshme, ku studente te cilet kane shprehur vleresimet per secilen lende/pedagog te semestrit (3780 vleresime per secilen pyetje). Pjesëmarrja sipas fakulteteve, programeve te studimit dhe viteve te studimit parqitet ne grafiket me poshte.


pjesëmarrja ne anketim




pjesëmarrja sipas cikleve



pjesmarrja sipas viteve



pjesmarrja sipas programeve



PJESMARRJA SIPAS PROGRAMEVE TE STUDIMIT


FAKULTETI EKONOMIK

■ Viti 1 ■ Viti 2 ■ Viti 3 ■ Viti 4 ■ Viti 5




FAKULTETI INXHINIERISE SE NDERTIMIT DHE ARKITEKTURES

■ Viti 1 ■ Viti 2 ■ Viti 3 ■ Viti 4 ■ Viti 5



FSHKIT

■ Viti 1 ■ Viti 2 ■ Viti 3 ■ Viti 4 ■ Viti 5



Fakti qe pjesa me e madhe e studenteve pjesemarres i perkasin viteve te para te studimeve (viti I, II) tregon se studentet e viteve me te larta e nuk paraqesin interesin maksimal per keto lloj anketimesh. Kjo kerkon qe te marrim masa per tu treguar studenteve vleren e informacioneve qe universiteti kerkon prej tyre. Kjo kerkon angazhimin me te madh te NJSBC si dhe gjetjen e formave te anketimit te studenteve qe te jene me gjithë perfshirese. Por sidoqofte numri i studenteve ne anketim eshte ne rritje.




❖ Vleresimi i aktivitetit të pedagogëve gjatë mesimdhenies


Ne kete seksion ju kerkohet te japin opinionet e tyre lidhur me aspekte te ndryshme te aktivitetit te pedagogut gjate procesit mesimor, gjate procesit te kontrollit te dijeve dhe ne fund nepermjet nje pyetje te vecante kerkohet nje opinion teresor per secilen lende dhe pedagog.

Rezultatet tregojne se ne rang universiteti 84 – 93% e studenteve jane shume te kenaqur dhe te kenaqur me aktivitetin e pedagogëve ne secilin nga aspektet e kerkuara si gjate procesit mesimor ashtu dhe ne ate te kontrollit te dijeve.

UMT-AKTIVITETI I PEDAGOGUT GJATE MESIMDHENIES




UMT-AKTIVITETI I PEDAGOGUT GJATE VLERESIMIT



UMT: Vleresimi i lendes/pedagogut

UMT-VLERESIMI LENDE/PEDAGOG



Ne te njejten menyre, opinioni perfundimtar i studenteve ne ne pyetjen per vleresimin e drejteperdrejte tregon se vleresimi i aktivitetit teresor te pedagogeve eshte si me poshte:

Vleresimi i pedagogeve	Studentet ne %
Shkelqyeshem	68 %
Shume mire	18%
Mire	9%
Mjaftueshem	3%
Jo mire	2%

Rreth 86 % e studenteve mendojne se lendet qe zhvillojne jane shume te vlefshme apo te vlefshme ne profilin e tyre.



Vleresimi i lendeve	Studentet ne %
Shume e vlefshme	67 %
E vlefshme	18%
Neutral	10%
Pak e vlefshme	3%
Aspak e vlefshme	2%




Te dhena me te hollesishme lidhur me vleresimet e studenteve ne rang fakulteti paraqiten si me poshte:

FAKULTETI I EKONOMISE

Fakulteti i Ekonomise: Aktiviteti i pedagogut gjate mesimdhenies


FAKULTETI I EKONOMISE



Fakulteti i Ekonomise: Aktiviteti i pedagogut gjate vleresimit


FAKULTETI I EKONOMISE

☐ Shkelqyeshem / Shume e vlefshme
 ☐ Shume mire / E vlefshme
 ☐ Mire / Neutral
☐ Mjaftueshem / Pak e vlefshme
 ☐ Jo mire / Aspak e vlefshme



Fakulteti i Ekonomise: Vleresimi i lendes/pedagogut

FAKULTETI I EKONOMISE



FAKULTETI I INXHINIERISE DHE ARKITEKTURES


Fakulteti i Inxhinierise dhe Arkitekture: Aktiviteti i pedagogut gjate mesimdhenies

FIA




Fakulteti i Inxhinierise dhe Arkitektures: Aktiviteti i pedagogut gjate vleresimit

FIA



Fakulteti i Inxhinierise dhe Arkitektures: Vleresimi i lendes/pedagogut


FIA



FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE DHE IT


Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT: Aktiviteti i pedagogut gjate mesimdhënies

FSHKIT




Fakulteti i Shkencave Kompiuterike dhe IT: Aktiviteti i pedagogut gjate vleresimit

FSHKIT



Fakulteti i Shkencave Kompiuterike dhe IT: Vleresimi Lende/Pedagog

FSHKIT



Ne sondazh perfshihen Aktiviteti i pedagogut gjate mesimdhenies, Aktiviteti i pedagogut gjate vleresimit, vleresi i lendes /pedagogut per cdo program.

Ne figuren me poshte jepet nje tablo e pergjitheshme e notave me te cilat jane vleresuar pedagoget nga studentet. Vihet re se nga 84 pedagoge, per te cilet jane dhene me shume se tri vlersime nga studentet, 74 prej tyre jane vlersuar me nota mbi 8 .

Vleresimet me note te pedagogeve te llogaritura nga te dhenat e pyetesoreve sipas metodologjise te pershkruar me lart do ti behen te njohura autoriteteve drejtuese te universitetit si dhe te dekanateve perkatese.

Nga pergjigjet duket se pedagoget krahas librave ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhe te huaj ofrojne prezantime, leksione te shkruara si dhe te rregjistruara ne platformen 'edu4school'.

Mbi 90% e studenteve pohojne se pedagoget perdorin per materialet mesimore te vendosura ne platformen 'edu4school'.



IV. PERFUNDIME DHE REKOMANDIME

- Ne rang Universiteti kane marre pjese ne anketim 756 studente, apo rreth 67 % e numrit total te studenteve.
Opinion i studenteve mbi aktivitetin e pedagogeve gjate procesit mesimor eshte mbledhur ne dy menyra. Nje here nepermjet pyetjeve lidhur me aspekte te vecanta te punes se pedagogeve gjate procesit mesimor dhe vleresimit te dijeve dhe nje here si opinion i pergjithshem i studenteve mbi kete aktivitet. Rezultatet tregojne se ne rang universiteti 86 % e studenteve jane shume te kenaqur dhe te kenaqur me aktivitetin e pedagogeve ne secilin nga aspektet e kerkuara si gjate procesit mesimor ashtu dhe ne ate te kontrollit te dijeve.
- Opinion i perfundimtar i studenteve tregon se rreth 68 % e studenteve e vleresojne aktivitetin teresor te pedagogeve drejtperdrejte "shkelqyeshem" 18% "shume mire", dhe 9% i vlereson "mire".
- Rreth 67 % e studenteve mendojne se lendet qe zhvillojne jane shume te vlefshme, 18% - te vlefshme ne profilin e tyre.
- Studentet deklarojne se pedagoget krahas librave ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhe te huaj ofrojne materiale mesimore ndihmese ne platformen 'edu4school', si prezantime, leksione te shkruara dhe/apo te rregjistruara.
- Kjo pohohet nga 90% e studenteve.

Kerkesat kryesore te studenteve

- Pergjithesisht komente pozitive per aktivitetin e pedagogeve te ndryshem.
- Nevoja e rritjes se bashkeveprimit pedagog - student gjate ores se mesimit

Permiresimi i procesit te organizimit te anketimit

- Studentet te jene me te vemendshem dhe te pergjegjshem ne plotesimin e pyetesorit
- Vihet re nje plotesim here here formal nga ana e studenteve, sidomos ata te viteve te larta.
- Shtrohet detyre qe ne te ardhmen te gjenden dhe forma te tjera sondazhesh.
- Duhet gjetur menyra per ti bindur studentet se informacioni qe ata percjellin nepermjet pyetesoreve eshte i dobishem dhe merret ne konsiderate nga autoritetet e UMT (nje raport i shkurter mund ti behet i njohur senatit te studenteve, apo te futet ne faqen e internetit te UMT, etj.).
- Duke nderhyre teknikisht ne algoritmin e pyetesorit u shmangen ngaterresat ne deklarimet e studenteve per sa i takon lendes dhe pedagogut perkates.





UNIVERSITETI
METROPOLITAN
TIRANA

Nr. 0 616/Piot
Dt. 26.07.2023

REZULTATET E VLERSIMIT TË PROCESIT TË MËSIMDHËNIES

VITI AKADEMIK 2022 - 2023, SEMESTRI II

NIKOLLA NIKA

Korrik 2023



Raport

mbi rezultatet e anketimit të studentëve të UMT për vlerësimin e procesit të mësimdhënies

Përgatitur nga:

Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë e Universitetit Metropolitan Tirana, UMT

Periudha e realizimit të pyetësorit:

Maj - Qershor 2023

Hartimi i Raportit:

Korrik -Gusht 2023

Universiteti "Metropolitan Tirana"

web: www.umd.edu.al

Email: inf@umd.edu.al



Permbajtja

I.	HYRJE	4
II.	QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT	5
III.	METODOLOGJIA DHE REZULTATET	7
IV.	REZULTATET	9
V.	PERFUNDIME DHE REKOMANDIME	22
VI.	ANEKSI I	23



I. HYRJE

Ne vazhdim te eksperiencës disa vjeçare në proceset e brendshme të sigurimit të cilësisë, Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) në Universitetin Metropolitan Tirana (UMT) në bashkëpunim me njesinë IT, zhvilluan me sukses anketimin e studentëve për mbledhjen e opinioneve lidhur me procesin mesimor gjatë semestrit të Dytë të vitit akademik 2023 -2023.

Per te vlerësuar opinionin e studenteve ne kete semester u hartua nje pyetesori i pergatitur ne formatin 'Google form'. Ne te njejten kohe pyetsori u pershtat dhe i u bashkengjit platformes "edu4school". Ne kete menyre u be e mundur qe pyetesori te plotesohej on-line si nepermjet linkut te 'Google form' ashtu edhe nepermjet platformes "edu4school".

Pyetesori ka qene i hapur per tu mbushur ne periudhen 15 Maj – 2 Qershor 2023 .

Plotësimi i pyetësorit të studentëve të Universitetit Metropolitan Tirana ka qenë anonim, individual dhe jo i detyrueshëm. Informacionet për përmbajtjen dhe plotësimin e tij janë bërë të ditur në mënyrë të vazhdueshme gjatë fazës së plotësimit të pyetësorit. Çdo student që ka gjykuar se plotësimi i pyetësorit është në të mirë të tij dhe institucionit, e ka plotësuar atë duke kontribuar në këtë mënyrë në njohjen e drejtuesve me mendimin e tyre për Universitetin Metropolitan Tirana dhe aspekteve të veçanta të funksionimit të tij.

Pyetesori permban pyetje lidhur me te gjithë aktivitetin e pedagogeve gjate procesit te mesimdhenies dhe te kontrollit te dijeve si dhe materialet mesimore qe ju ofrohen studenteve.

Rezultatet e pyetësorit u analizuan për të nxjerrë në pah vlerësimin real të studentëve dhe për të adresuar problematikat e evidentuara. Keto rezultate janë publikuar në këtë raport.

Si gjithmon, rezultatet e anketimit duhet te konsiderohen te nivelit informativ.



II. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Pyetësi i studentëve të UMT është një procedurë e përvitëshme që kryhet nga NJSBC me qëllim monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në institucionin tonë duke u fokusuar në indikatorë të përgjithshëm dhe indikatorë specifikë të vlerësimit dhe monitorimit.

Ky sondazh që përgjithësisht realizohet çdo semester ka disa objektiva madhorë të cilat lidhen me mbledhjen e informacioneve periodike nga studentët për ecurinë e procesit mësimor, vlerësimin e provimeve të ndërmjetme dhe të praktikave profesionale që realizohen gjatë vitit akademik. Ky opinion ndihmon vendimmarrjen e organeve drejtuese në përmirësimin e performancës së universitetit në drejtime të cilat sipas studentëve duhet të performojnë më mirë. Në të njëjtën kohë, analiza e rezultateve shërben për përpunime krahasuese nga viti në vit në lidhje me ecurinë e treguesve të ndryshëm të universitetit. Njëkohësisht, informacionet u shërbejnë studentëve dhe maturantëve për të njohur më mirë UMT nën këndvështrimin e studentëve.

Për zhvillimin e këtij anketimi, NJSBC ka zbatuar disa akte të cilat janë orientuese dhe njëkohësisht detyruese për institucionet e arsimit të lartë.

Anketimi i studentëve është një proces i parashikuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 datë 22.7.2015, Kreu X, Neni 103 "*Sigurimi i brendshëm i cilësisë*", si një ndër masat e marra në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies ku thuhet shprehimisht:

- *Institucionet e arsimit të lartë janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Struktura dhe funksionimi i njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë.*
- *Njësia e sigurimit të cilësisë vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore.*
- *Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, ajo organizon pyetësin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi.*
- *Njësia e sigurimit të cilësisë realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga institucioni i arsimit të lartë.*
- *Raportet e vlerësimeve, të kryera nga njësitë për sigurimin e brendshëm të cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë, përdoren si burim për vlerësimin e jashtëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.*

Po ashtu ky sondazh bazohet në standardet dhe kriteret e cilësisë të programeve të studimit, pjesë e Kodit të Cilësisë në arsimin e lartë (*Për programet e studimit të ciklit*



të parë bachelor, ciklit të dytë "master profesional", ciklit të dytë "master i shkencave" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë "master i shkencave")

"III. Mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi dhe kompetencat

Standardi III.

Kriteri 1 institucioni ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit

Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.

Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.

Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.

Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies."

Ky pyetësor bazohet në Statutin e UMT, Rregulloren e institucionit dhe Rregulloren e NJSBC ku në themel të së cilëve është monitorimi i vazhduar dhe siguri i cilësisë së programeve të studimit dhe i mësimdhënies.

Më poshtë do të pasqyrojmë në mënyrë të detajuar të gjithë hapat e ndjekur për realizimin e procesit të anketimit e deri në gjenerimin e rezultateve dhe hartimin e përfundimeve.

III. METODOLOGJIA

Pyetësi u përgatit nga NJSBC dhe synon mbledhjen e informacionit rreth kenaqesise se studenteve me aktivitetin e pedagogëve gjatë orës së mesimit, materialeve mesimore dhe gjatë kontrollit të dijeve. Përveç kësaj aty janë përfshirë edhe disa pyetje për mbështetjen që marrin studentët nga strukturat akademike dhe administrative të UMT.

Pyetësi, që është bashkëngjitur në aneksin 1, përmban 25 pyetje që janë të fokusuara në 4 seksione:

Seksioni A:

Identifikimi i studentit – 3 pyetje (Fakulteti, programi, viti i studimit)

Seksioni B:

- Mesimdhenia - 8 pyetje (me 5 opsione)
- Kontrolli i dijeve – 5 pyetje (me 5 opsione)
- Vlerësim total i lëndës/pedagogut – 2 pyetje (me 5 opsione)

Pyetjet e këtij seksioni përsëriten për të gjitha lëndet/pedagoget e semestrit (janë parashikuar 5 lëndë)

- Komente të përgjithshme mbi lëndet/pedagoget

Çdo seksion përbëhet nga një seri pyetjesh të cilat fokusohen në aspekte të veçanta të procesit të mesimdhenies e mesimnxenies nepermjet të cilave tentohet të mblidhet informacion mbi vlerësimin nga ana e studentit të lëndës dhe pedagogut përkatës.

Përgjigjet e pyetësorëve janë transformuar në formatin Excel dhe me pas janë përpunuar me metoda grafike dhe statistikore.

Në pyetjet e seksionit B, që lidhen me vlerësimin e aktivitetit të pedagogut gjatë mesimdhenies dhe kontrollit të dijeve, studentit i kërkohet të shprehet se në çfarë shkalle është dakort (Shume dakort, Dakort, Neutral, Jo dakort, Aspak dakort) me pohimet që lidhen me aspekte të ndryshme të kësaj aktiviteti. Në pyetjen e fundit atyre i kërkohet të vlerësojnë aktivitetin e pedagogut në teresi sipas shkalles – Shkelqyeshëm, Shume mire, Mire, Mjaftueshëm dhe Jo mire.

Për vlerësimin me note të pedagogëve, vlerësimet e shkalleve të mesiperme janë konvertuar në nota sipas tabelës me poshtë.



Vleresimi	Nota	Vleresimi	Nota
Shume dakort	10	Shkelqyeshem	10
Dakort	8	Shume mire	8.5
Neutral	6	Mire	7
Jo dakort	4	Mjaftueshem	5
Aspak dakort	2	Jo mire	4

Ne kete menyre vleresimi me note i pedagogeve eshte kryer ne dy menyra. Menyra e pare eshte ajo e konvertimit ne note te pergjigjeve te pyetjes "Vleresimi juaj mbi aktivitetin e pedagogut", ndersa menyra e dyte lidhet me konvertimin ne note te pergjigjeve te dhena per aktivitetet e ndryshme te procesit te mesimdhenies dhe te kontrollit te dijeve.

Perveç vleresimit te mesiperm kemi gjykuar se eshte me interes te vleresojme edhe shperndarjen e pergjigjeve te pyetjeve duke i grupuar ato ne tri grupe kryesore si me poshte:

Grupi	Pergjigjet e pyetjeve me vleresim
"Te kenaqur"	"Shume dakord" e "Dakord"
"Neutral"	"Neutral"
"Te pa kenaqur"	"Jo dakord" dhe "Aspak dakord"


IV. REZULTATET

❖ Pjesemarrja ne anketim


Te dhenat e paraqitura ne kete raport i perkasin nje periudhe 2 javore gjate se ciles pyetesorin e kane plotesuar nje numer studentesh si me poshte.

Ne rang Universiteti kane marre pjese ne anketim 595 studente, apo rreth 53% e numrit total te studenteve. Duhet theksuar se te dhena te vlefshme jane dhene nga 443 studente te cilet kane shprehur vleresimet per secilen lende/pedagog te semestrit (2290 vleresime per secilen pyetje). Pjesemarrja sipas fakulteteve, programeve te studimit dhe viteve te studimit paraqitet ne grafiket me poshte.


Pjesemarrja ne anketim




Pjesemarrja sipas cikleve te studimit



Pjesemarrja sipas cikleve dhe viteve te studimit



Pjesemarrja sipas programeve dhe viteve te studimit



Fakti qe pjesa me e madhe e studenteve pjesemarres i perkasin viteve te para te studimeve (viti I, II) tregon se studentet e viteve me te larta e nuk paraqesin interesin maksimal per keto lloj anketimesh. Kjo kerkon qe te marrim masa per tu treguar studenteve vleren e informacioneve qe universiteti kerkon prej tyre. Kjo kerkon angazhimin me te madh te NJSBC si dhe gjetjen e formave te anketimit te studenteve qe te jene me gjithë perfshirese. Por sidoqofte numri i studenteve ne anketim eshte ne rritje.




❖ Vleresimi i aktivitetit të pedagogëve gjatë mesimdhenies


Në këtë seksion ju kërkohej të japin opinionet e tyre lidhur me aspekte të ndryshme të aktivitetit të pedagogut gjatë procesit mesimor, gjatë procesit të kontrollit të dijeve dhe në fund nepermjet një pyetje të vecante kërkohej një opinion teresor për secilën lende dhe pedagog.

Rezultatet tregojnë se në rang universiteti 84 – 93% e studenteve janë shumë të kenaqur dhe të kenaqur me aktivitetin e pedagogëve në secilin nga aspektet e kërkuara si gjatë procesit mesimor ashtu dhe në ato të kontrollit të dijeve.


UMT - Aktiviteti i pedagogut gjatë mesimdhenies



UMT - Aktiviteti i pedagogut gjate vleresimit



UMT - Vleresimi i lendes/pedagogut




Ne te njejten menyre, opinioni perfundimtar i studenteve ne ne pyetjen per vleresimin e drejteperdrejte tregon se vleresimi i aktivitetit teresor te pedagogeve eshte si me poshte:

Vleresimi i pedagogeve	Studentet ne %
Shkelqyeshem	53 %
Shume mire	14%
Mire	26%
Mjaftueshem	4%
Jo mire	3%

Rreth 86 % e studenteve mendojne se lendet qe zhvillojne jane shume te vlefshme apo te vlefshme ne profilin e tyre.

Vleresimi i lendeve	Studentet ne %
Shume e vlefshme	64 %
E vlefshme	22%
Neutral	9%
Pak e vlefshme	2%
Aspak e vlefshme	2%


UMT - Aktiviteti i pedagogut gjate vleresimit




Te dhena me te hollesishme lidhur me vleresimet e studenteve ne rang fakulteti paraqiten si me poshte:

Fakulteti i Ekonomise:

FE - Aktiviteti i pedagogut gjate mesimdhenies



FE - Aktiviteti i pedagogut gjate vleresimit




FE - Vleresimi i lendes/pedagogut




Fakulteti i Inxhinierise dhe Arkitektures:


FIA - Aktiviteti i pedagogut gjate mesimdhenies




FIA - Aktiviteti i pedagogut gjate vleresimit




FIA - Vleresimi i lendes/pedagogut



FSHKIT - Aktiviteti i pedagogut gjate mesimdhenies



FSHKIT - Aktiviteti i pedagogut gjate vleresimit




FSHKIT - Vleresimi i lendes/pedagogut



Me poshte analizohen dhe perfshihen Aktiviteti i pedagogut gjate mesimdhenies, Aktiviteti i pedagogut gjate vleresimit, vleresi i lendes /pedagogut per cdo program. Ne figuren me poshte jepet nje tablo e pergjitheshme e notave me te cilat jane vleresuar pedagoget nga studentet. Vihet re se nga 121 pedagoge, (vjetor) per te cilet jane dhene me shume se tri vlersime nga studentet, 114 prej tyre jane vlersuar me nota mbi 8 dhe vetem nje pedagog eshte vleresuar me note nen 7.

Vleresimi i pedagoqeve (nota)



Vleresimet me note te pedagoqeve te llogaritura nga te dhenat e pyetesoreve sipas metodologjise te pershkruar me lart do ti behen te njohura autoriteteve drejtuese te universitetit si dhe te dekanateve perkatese.

Nga pergjigjet duket se pedagoget krahas librave ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhe te huaj ofrojne prezantime, leksione te shkruara si dhe te rregjistruara ne platformen 'edu4school'.

Mbi 90% e studenteve pohojne se pedagoget perdorin per materialet mesimore te vendosura ne platformen 'edu4school'.



V. PERFUNDIME DHE REKOMANDIME

- Ne rang Universiteti kane marre pjese ne anketim 595 studente, apo rreth 53 % e numrit total te studenteve, nga te cilet 443 studente kane dhene te dhena te vlefshme.
- Opinioni i studenteve mbi aktivitetin e pedagogeve gjate procesit mesimor eshte mbledhur ne dy menyra. Nje here nepermjet pyetjeve lidhur me aspekte te vecanta te punes se pedagogeve gjate procesit mesimor dhe vleresimit te dijeve dhe nje here si opinion i pergjithshem i studenteve mbi kete aktivitet. Rezultatet tregojne se ne rang universiteti 84 – 93% e studenteve jane shume te kenaqur dhe te kenaqur me aktivitetin e pedagogeve ne secilin nga aspektet e kerkuara si gjate procesit mesimor ashtu dhe ne ate te kontrollit te dijeve.
- Opinioni perfundimtar i studenteve tregon se rreth 67 % e studenteve e vleresojne aktivitetin teresor te pedagogeve drejtperdrejte "shkelqyeshem" dhe "shume mire", dhe 27% i vlereson "mire".
- Rreth 86 % e studenteve mendojne se lendet qe zhvillojne jane shume te vlefshme apo te vlefshme ne profilin e tyre.
- Studentet deklarojne se pedagoget krahas librave ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhe te huaj ofrojne materiale mesimore ndihmese ne platformen 'edu4school', si prezantime, leksione te shkruara dhe/apo te regjistruara.
- Kjo pohohet nga 90% e studenteve.

Kerkesat kryesore te studenteve

- Pergjithesisht komente pozitive per aktivitetin e pedagogeve te ndryshem.
- Nevoja e rritjes se bashkeveprimit pedagog - student gjate ores se mesimit

Permiresimi i procesit te organizimit te anketimit

- Studentet te jene me te vemendshem dhe te pergjegjshem ne plotesimin e pyetesorit
- Duhet gjetur menyra per ti bindur studentet se informacioni qe ata percjellin nepermjet pyetesoreve eshte i dobishem dhe merret ne konsiderate nga autoritetet e UMT (nje raport i shkurter mund ti behet i njohur senatit te studenteve, apo te futet ne faqen e internetit te UMT, etj.).
- Duhet nderhyre teknikisht ne algoritmin e pyetesorit qe te mos kete vend per ngateresa ne deklarimet e studenteve per sa i takon lendes dhe pedagogut perkates.

